




REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-1364/2012</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>17-04-2012</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.04.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-4812/11, për z.Besim Baraliu, Drejtor i Bordit në KRU “HIDRODRINI JUGOR”SH.A-Prizren, për shkak se zyrtari i Lartë Publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për Konflikt të Interesit me numër protokolli AKK–03-4812/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e lartë z. Besim Baraliu, Drejtor i Bordit në KRU “HIDRODRINI JUGOR”SH.A-Prizren.

Pas zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë publik, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit Publik ka qenë i regjistruar në ARBK, si Drejtor dhe person i autorizuar në biznesin më emër “Newco Cafe Restaurant Marashi- L.L.C” e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të interesit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave zyrtari i lartë z. Besim Baraliu ka ardhur në Agjenci dhe kemi biseduar për gjendjen dhe faktet që disponon Agjencia lidhur me gjendjen e mundshme të Konfliktit të interesit, zyrtari i lartë z. Baraliu gjatë takimit është pajtuar për situatën mirëpo është arsyeuar se nuk ushtron pozitë në këtë biznes pasi që aksionar i vetëm në këtë biznes është vllau i tij Halim Baralija, cili këtë biznes e ka privatizuar nga AKM, mirëpo kur është regjistruar është

marr vetëm si emër për ti përmbushur obligimet administrative, dhe së biznesi udhëhiqet nga djali vllau i tij Armend Baralija, mirëpo të dhënat e mëhershme nuk janë ndryshuar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, Zyrtari Lartë z.Baraliu është zotuar se ne afatin ligjor do të kërkoj nga pronarët që të bëhen ndryshimet në këtë biznes dhe do ta shmangë Konfliktin e mundshëm të Interesit.

Zyrtari i Lartë z. Besim Baraliu brenda afatit ligjore ka sjellë dëshmitë nga ARBK-ja, se janë bërë ndryshimet e kërkuar dhe se emri i tij nuk figuron me si Drejtor dhe agentit i regjistruar në biznesin "Newco Cafe Restaurant Marashi - L.L.C".

Konstatohet se z. Besim Baraliu ka sjellë dokumentet e nevojshëm që dëshmojnë se nuk është më në pozitën e Drejtorit dhe të personit të autorizuar në biznesin më emër "Newco Cafe Restaurant Marashi - L.L.C".

Andaj u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

